SYNIMET KRYESORE PËR ÇDO FUSHË / PËRGJEGJËSITË

Në mbështetje të "Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Maliq – Plani i Zhvillimit të Territorit", miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 51, datë 03.07.2020 dhe miratuar nga KKT me Vendim nr. 5, datë 14.10.2020, synimet kryesore konsistojnë në:

- Përmirësimin e infrastrukturës publike dhe rrjetit rrugor vendor;
- Zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë dhe agropërpunimit;
- Përmirësimin e shërbimeve publike dhe cilësisë së jetesës;
- Zhvillimin e turizmit, rekreacionit dhe hapësirave të gjelbra;
- Mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e burimeve natyrore;
- Forcimin e infrastrukturës sociale, arsimore, kulturore dhe sportive;
- Rritjen e investimeve dhe zhvillimin ekonomik vendor;
- Përmirësimin e planifikimit territorial dhe administrimit urban.